



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E GJILANIT  
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

AD.GJTH.GJL.nr.2/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas kërkesave të palës A Sh [REDACTED] nga Gjilani, të datës 29.01.2024, 08.02.2024 dhe 12.02.2024, për iniciimin e procedurës disiplinore konform nenit 9 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të paraqitur ndaj gjyqtares E [REDACTED] E [REDACTED]-T [REDACTED], gjyqtare në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, me datë 20.02.2024, mori këtë:

AKTVENDIM

REFUZOHET e pabazuar kërkesat e palës A Sh [REDACTED] nga Gjilani, edhe atë të datës 29.01.2024, datës 08.02.2024 dhe datës 12.02.2024, për iniciimin e procedurës disiplinore konform nenit 9 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të paraqitur ndaj gjyqtares E [REDACTED] E [REDACTED]-T [REDACTED], gjyqtare në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan.

Arsyetim

Parashtruesi i ankesës, A Sh [REDACTED] nga Gjilani, më datë 29.01.2024, 08.02.2024 dhe 12.02.2024 ka paraqitur ankesë urgjente ndaj gjyqtares E [REDACTED] E [REDACTED]-T [REDACTED].

Në ankesën e datës 29.01.2024 ka theksuar se më datë 12.12.2023 i është dërguar thirrja për shqyrtimin gjyqësor të datës 10.01.2024 nga gjyqtarja e çështjes E [REDACTED] E [REDACTED]-T [REDACTED] për lëndën në procedurë C.nr.2429/23 dhe të njëjtën përmes parashtrësës së datës 29.12.2023 e ka njoftuar se nuk do të marrë pjesë në seancë. Një ditë pas seancës, më datë 11.01.2024 ka kërkuar nga gjyqtarja e çështjes të informohet lidhur me mbarëvajtjen e seancës, por e njëjta nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret lidhur me këtë kërkesë.

Në ankesën e datës 08.02.2024 ka theksuar se gjyqtarja e çështjes nuk ka trajtuar ankesën e tij të datës 05.01.2024, por më datë 24.01.2024 ka nxjerrë aktvendim për ndërprerje të procedurës dhe me këtë ka vepruar në kundërshtim me LPK-në. Ka shtuar se me këtë veprim nuk është trajtuar në mënyrë efikase ankesa e tij e datës 05.01.2024, ndërsa është favorizuar pala paditëse, prandaj gjyqtarja e çështjes nuk ka

vepruar me kohë, ka bërë neglizhencë të qëllimshme, duke krijuar pasiguri juridike dhe zvarritje të zgjidhjes së lëndës. Me këtë ka konsideruar se gjyqtarja E [REDAKTUAR] E [REDAKTUAR]-T [REDAKTUAR] ka bërë shkelje të kodit të etikës. Ankesës i ka bashkëngjitur ankesën e datës 05.01.2024, në të cilën konstatohet se i njëjti i ka përshkruar gjyqtares së çështjes ankesat ndaj gjyqtarit paraprak që ka trajtuar lëndën dhe veprimet të cilat sipas tij janë tendencioze.

Në ankesën e datës 12.02.2024 ka theksuar se aktvendimi i datës 24.01.2024 për ndërprerje të procedurës për shkak të vdekjes së palës në kontest E [REDAKTUAR] Sh [REDAKTUAR], është tendencioz dhe shërben për zvarritje të procedurës, për shkak se gjyqtarja e çështjes nuk ka trajtuar paraprakisht kërkesën e datës 09.01.2024 të ankuesit. Në kërkesën e datës 09.01.2024, ankuesi i ka kërkuar gjyqtares së çështjes të anulojë seancën e planifikuar më datë 10.01.2024.

Kryetari i gjykatës, për shkak të pretendimeve ankimore të ngashme në të tri ankesat, i shqyrtoi të gjitha përnjëherë dhe bazuar në parimin e ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës, vlerësoi se të njëjtat duhet të vendosen me një vendim të vetëm.

Në ankesat e parashtruesit është bashkëngjitur edhe aktvendimi C.nr.2429/23 i datës 24.01.2024 i gjyqtares së çështjes E [REDAKTUAR] E [REDAKTUAR]-T [REDAKTUAR], me të cilin aktvendim është ndërprerë procedura sipas kësaj lënde për shkak të vdekjes së palës E [REDAKTUAR] Sh [REDAKTUAR].

Kryetari i gjykatës, pas analizimit të pretendimeve të palës ankuese dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se kërkesa e palës A [REDAKTUAR] Sh [REDAKTUAR] është e pabazuar.

Deri te një përfundim i tillë, kryetari i gjykatës ka ardhë duke u bazuar në faktin se pretendimet e palës A [REDAKTUAR] Sh [REDAKTUAR] konsistojnë kryesisht në vendimmarrjen e gjyqtares së çështjes E [REDAKTUAR] E [REDAKTUAR]-T [REDAKTUAR] sa i përket aktvendimit për ndërprerje të procedurës, të cilat nuk janë kompetencë e kryetarit t'i vlerësojë. Kryetari i gjykatës kufizohet në vlerësimin e shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve, ndërsa pala ankuese në anën tjetër ka gjithmonë të drejtën që të shfrytëzojë mjetet juridike në instancat më të larta gjyqësore sa i përket atakimit të vendosjes nga ana e gjykatës. Sa i përket pretendimeve për veprime tendencioze dhe qëllime të zvarritjes së procedurës për shkak të vendosjes së ndërprerjes së procedurës e mos trajtimit të ankesave paraprake nga pala ankuese, kryetari i gjykatës vlerëson se të njëjtat pretendime nuk mund të justifikohen objektivisht, pasi gjyqtarja e çështjes ka caktuar shqyrtim gjyqësor pas pranimit të parashtrësive nga pala ankuese, ndërsa i njëjti nuk ka prezantuar në seancë. Kryetari i gjykatës vlerëson se nuk është kompetencë e gjyqtares së çështjes t'i përgjigjet ankesave të palëve në kontest lidhur me shqetësimet e tyre sa i përket trajtimit të lëndës nga gjyqtari paraprak, e as të anulojë seancë kur nuk plotësohen kushtet ligjore të përcaktuara në LPK për këtë shkak.

Përfundimisht, kryetari i gjykatës ka gjetur se nuk është përmbushur asnjë nga pikat e parapara në nenin 5, paragrafi të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Prokurorë dhe Gjyqtar, andaj konform nenit 9 paragrafi, 6 të po të njëjtit ligj, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kryetari i gjykatës  
Venhar SALIMU

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Parashtruesit të kërkesës,
2. KGJK-së,
3. Dosjës së lëndës.